LIGJ
Nr.9672, datë 29.12.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR, 1998"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar, 1998 për projektin "Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla në zonat rurale dhe urbane"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5185, datë 12.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 1998

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë:

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore ndërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 17 prill 1998,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe marrësve të tjerë, që do të zgjidhen bashkërisht nga të dy Qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt fur Wiederaufbau, Frankfurt mbi Majn, shumat e mëposhtme:

1) një hua me vleftë prej gjithsej deri në 2.600.000-- euro (me fjalë: dy milionë e gjashtëqind mijë euro) për projektin "Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla në zonat fshatare dhe urbane", kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti në fjalë vlen për t'u mbështetur;

2) një shumë financimi me vleftë prej gjithsej deri në 210.000-- euro (me fjalë: dyqind e dhjetë mijë euro) për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në pikën 1.

2. Po të merren vesh Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e

Republikës Federalë të Gjermanisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me një projekt tjetër.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt fur Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

4. Shumat e financimit për masat përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 1 pikë 2, në rast se nuk përdoren për masa të tilla, do të kthehen në hua.

Neni 2

1. Përdorimi i shumave të përmendura në nenin 1, kushtet me të cilat vihen në dispozicion ato, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt fur Wiederaufbau dhe Huamarrësit resp. marrësit të shumës së financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Premtimi i shumave të përmendura në nenin 1 paragrafi 1 pikat 1 dhe 2 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse për marrjen e huasë dhe për financim nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumat në fjalë, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2006.

2. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj Kreditanstalt fur Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për plotësimin e detyrimeve të huamarrësve në bazë të kontratave që do të përfundohen sipas paragrafit 1.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt fur Wiederaufbau për pretendime eventuale lidhur kthimin e shumës, të cilat mund të ngrihen në bazë të kontratës së financimit që do të përfundohet sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt fur Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezulton nga dhënia e huasë dhe nga dhënia e shumës së financimit, nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë më datë 8.11.2006 në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.